



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.24.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndërmarr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Faik Thaqi dhe Elvir Krasniqi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	8
2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm.....	10
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	13
4 Qeverisja	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP.....	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2014, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e saj për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorin Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit të datës 03.10.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve:

Komuna nuk i kishte prezantuar në PVF 89,000€ si pagesa nga palët e treta;

Për shkak të ndryshimeve të mëdha në realizimin e një projekti kapital në vlerë 94,193€, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri për vlerën e paguar nëse projekti i përfunduar është ekuivalent me vlerën e parasë së shpenzuar;

Kategoria e investimeve kapitale ishte mbivlerësuar për 65,500€ si dhe mallrat dhe shërbimet dhe subvencione e transfere janë nënvlerësuar për të njëjtën shumë; dhe

Një pagesë prej 20,000€ i ishte bërë The Regional Environmental Center (REC) për një projekt që nuk ishte implementuar në vitin 2014, dhe është regjistruar si shpenzim kapital. Gjithashtu, komuna kishte kryer pagesa në llogari të donatorëve në shumë prej 40,033€. Donatorët nuk kishin ofruar asnjë dokument relevant, si: faturë, raport të punës/mbikqyrjes.

Theksim i çështjes


Si *Theksim i çështjes* dëshirojmë të përmendim faktin se Shpalosja e Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm, pasi i njëjti nuk përfshin Investimet në Vijim.


(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).


Konkluzioni i përgjithshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm në nivelin e tanishëm, nuk ofron sigurinë e duhur se aktivitetet operative dhe financiare të komunës kryhen në mënyrë efektive dhe efikase, dhe si i tillë ka nevojë të ketë një mbikëqyrje të shtuar dhe përmirësim në disa fusha kyçe të menaxhimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:







Përgjigjja e Menaxhmentit –auditimit i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

Ne e marrim si punë të kryer që Kryetari :

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të komunës të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shpreh opinionin:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e ndërmjetme të auditimit ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para përgatitjes së PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat Vjetore Financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i Komunës dhe Zyrtaari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm lidhur me cilësinë dhe saktësinë e PVF-të është se janë identifikuar gabime materiale që kanë të bëjnë me prezantimin e pagesave nga palët e treta, pagesa të parregullta, keq klasifikimi i shpenzimeve dhe regjistrimin jo të saktë të investimeve në vijim, ndërsa sa i përket kërkesave të raportimit të jashtëm ato ishin plotësuar.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, me përjashtim të çështjeve:

Komuna nuk i kishte prezantuar në PVF 89,000€ si pagesa nga palët e treta;

Për shkak të ndryshimeve të mëdha në realizimin e një projekti kapital në vlerë 94,193€, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri për vlerën e paguar nëse projekti i përfunduar është ekuivalent me vlerën e parasë së shpenzuar;

Kategoria e investimeve kapitale ishte mbivlerësuar për 65,500€ si dhe mallrat dhe shërbimet dhe subvencione e transfere janë nënvlerësuar për të njëjtën shumë; dhe

Një pagesë prej 20,000€ i ishte bërë The Regional Environmental Center (REC) për një projekt që nuk ishte implementuar në vitin 2014, dhe është regjistruar si shpenzim kapital. Gjithashtu, komuna kishte kryer pagesa në llogari të donatorëve në shumë prej 40,033€. Donatorët nuk kishin ofruar asnjë dokument relevant, si: faturë, raport të punës/mbikqyrjes.

Theksim i çështjes

Si *Theksim i çështjes*, dëshirojmë të përmendim faktin se Shpalosja e Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm, pasi i njëjti nuk përfshin Investimet në Vijim.

(SNISA 200/1705: Opinion i Kualifikuar me Theksim të Çështjes).

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të dërguar me 03.10.2014, është identifikuar vetëm një rrezik domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive dhe prezantimin e tyre në PVF. Në fazën e ndërmjetëm të auditimit ne kemi dhënë këshillën që pasuritë duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël. Rreziku nuk ishte materializuar për shkak se komuna kishte marr parasysh këshillën tonë dhe kishte regjistruar pasuritë në regjistrin kontabël.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Komuna duhet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ajo kishte përmbushur kërkesat raportuese si në vijim:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2013 për PVF;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet Operacionale (performancës); dhe
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit me kohë.

Komuna kishte përgatitur draft PVF në afatin ligjor, por që të njëjtat i kishte modifikuar, dhe më 25.03.2015 ka dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF) versionin final.

Çështja 1 - Procesi i përgatitjes së PVF - prioritet i lartë

- E gjetura** Neni 12 pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme tek shtylla pagesat nga palët e treta komuna nuk i ka prezantuar 89,000€ si përfitim nga Qeveria Norvegjeze për projektin “Instalimi i shenjave në trafik”;
- Komuna kishte bërë pagesa të parregullta në vlerë 60,033€ nga kategoria investime kapitale vetëm në bazë të memorandumit apo marrëveshjeve. (Për më tepër shih çështjen 6);
- Për shkak të ndryshimeve të mëdha në kontratë, ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri për vlerën e paguar prej 94,193€ nëse projekti i përfunduar është ekuivalent me vlerën e parasë së shpenzuar. (Për më tepër shih çështjen 5); dhe
- Komuna e Vushtrrisë kishte keq deklaruar në PVF shpenzimet e investimeve kapitale ku nga kategoria e investimeve kishte paguar mallra dhe shërbime, dhe subvencione në vlerë prej 65,500€.
- Rreziku** Paraqitja jo e saktë e të dhënave në PVF dhe gabimeve të identifikuara në shumatat e regjistruara shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës. Paraqitja e gabuar e pagesave nga palët e treta, pagesat e parregullta dhe keq klasifikimi i shpenzimeve kanë ndikuar në Kualifikimin e Opinionit.
- Rekomandimi 1** Kryetari duhet t’i identifikojë arsyet për gabime e bëra në PVF dhe të siguroj se proceset e rishikimeve nga menaxhmenti do të përmirësohen për PVF-të e 2015 në mënyrë që të sigurohet se gabimet janë identifikuar dhe korrigjuar para se PVF të dorëzohen në Qeveri.
-

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar me kohë planin për adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak. Megjithatë, një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar, por disa prej tyre ose janë adresuar pjesërisht, ose fare nuk janë adresuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 të Komunës kishte rezultuar me 14 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, 6 (gjashtë) rekomandime ishin adresuar plotësisht, 4 (katër) ishin adresuar pjesërisht, dhe 4 (katër) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Rekomandimi

Çështja 2 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Rekomandimet e vitit paraprak nuk janë zbatuar plotësisht, sepse Komuna nuk ka një proces formal për të siguruar që të gjitha rekomandimet adresohen në mënyrë aktive dhe brenda afateve të përcaktuara kohore. Si të tilla, në këtë Raport Auditimi, përsëri janë ngritur çështjet për përmirësim të aktiviteteve të caktuara.
- Rreziku** Mos adresimi i plotë i rekomandimeve paraqet rrezik që gjetjet e auditimit bashkë me rekomandimet të përsëriten edhe në të ardhmen.
- Rekomandimi 2** Kryetari duhet të sigurojë se një plan veprimi i rishikuar, përcakton një orar të qartë të zbatimit, personat përgjegjës dhe aktivitetet e nevojshme për adresimin e rekomandimeve. Plani duhet të përmbajë prioritete dhe të përqendrohet fillimisht në trajtimin e fushave të rëndësishme më të madhe, si dhe të mbikëqyret direkt nga Kryetari i komunës.

4 Qeverisja

Konkluzion i Përgjithshëm

Komuna e Vushtrrisë nuk i ka adresuar plotësisht gabimet materiale në PVF si dhe ato nuk ishin të një cilësie të duhur. Në kontekstin e sistemeve menaxhuese, ne kemi identifikuar përparim pozitiv tek pasuritë e komunës.

Megjithatë, komuna ka arritur të adresoj mirë shkurtimin buxhetor prej 15% tek mallrat dhe shërbimet dhe raporti i jashtëm i auditimit është diskutuar në asamblenë komunale.

Vetë-vlerësimi – ishte kompletuar në kohë, megjithatë ne inkurajojmë që komuna të zbatoj një qasje kritike gjatë vetëvlerësimit si një pikë fillestare për përmirësimin e performances aty ku është e nevojshme.

Menaxhimi i rrezikut –komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara për identifikimin dhe menaxhimin e rrezikut, të cilat do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me objektivat e komunës.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit të të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme. Kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Vushtrrisë, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Për më shumë të dhënat janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	13,419,233	15,472,148	14,103,855	12,243,211	12,046,196
Granti i Qeverisë -Buxheti	11,767,233	12,976,097	12,756,447	10,948,734	10,857,784
Të bartura nga viti paraprak ²	0	417,271	404,515	411,489	358,838
Të hyrat vetjake ³	1,652,000	1,652,000	889,043	824,543	753,292
Donacionet e brendshme	0	69,319	44,877	40,453	60,969
Donacionet e jashtme	0	357,461	8,973	17,992	15,313

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 2,052,915€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të brendshme dhe të jashtme (426,780€) të hyrave të bartura nga viti paraprak (417,271€), dhe rritja e grantit qeveritar për shkak të rritjes së pagave (1,208,864€).

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimet	2012 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	13,419,233	15,472,148	14,103,855	12,243,211	12,046,196
Pagat dhe Mëditjet	7,310,541	8,597,927	8,497,773	7,271,207	7,222,254
Mallrat dhe Shërbimet	1,365,862	1,518,426	1,204,039	1,196,406	1,214,565
Shërbimet komunale	248,360	248,360	194,144	173,076	189,685
Subvencionet dhe Transferet	266,375	269,905	242,980	163,193	127,753
Investimet Kapitale	4,228,095	4,837,530	3,964,919	3,439,329	3,391,939

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

³ Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të shpenzuara

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit 2014, vetëm 82% e buxhetit ishte shpenzuar për këtë kategori;
- Buxheti për paga dhe mëditje ishte shpenzuar në shkallë maksimale (99%);
- Vendimi i qeverisë për reduktimin e shpenzimeve prej 15% për mallra dhe shërbime ka ndikuar që shpenzimi të jetë vetëm 78% për këtë kategori, ndërsa një shkallë më e lartë e ekzekutimit vërehet tek subvencionet (90%);
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje në shumë 1,287,386€ dhe Mallra dhe Shërbime për 152,564€ është si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm; dhe
- Ekzekutimi i buxhetit në vitin 2014 është rreth 91%, dhe krahasuar me vitin 2013 (93%) vërehet një rënie e lehtë.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	1,652,000	1,652,000	1,369,707	1,213,178	1,157,577

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2014 janë realizuar në nivelin rreth 83% dhe kanë shënuar rritje prej 156,529€ (13%) në krahasim me të hyrat e vitit 2013.

Rekomandimi

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim në këtë fushë

4.2 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Komuna e Vushtrrisë në përgjithësi ka të vendosura kontrole që ndërlidhet me mbledhjen e të hyrave vetjake. Më tutje, ekziston nevoja për përmirësimin e disa proceseve për ta mbështetur mbledhjen e të hyrave. Në procesin e mbledhjes (menaxhimin) e të hyrave vetjake, identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 3 - Dhënia e pronës komunale me qira - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Vushtrrisë në vitin 2014 nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë veprimi ndaj shfrytëzuesve të cilët nuk kishin kryer obligimet financiare për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

Për shfrytëzimin e pronës komunale, ne testuam katër mostra ku obligimi financiar i tyre për vitin 2014 ishte 10,389€ i cili nuk ishte mbledhur nga komuna gjatë vitit 2014.

Rreziku Mos arkëtimi i të hyrave vetjake nga dhënia e pronës komunale me qira ndikon që të hyrat e planifikuara të mos mblidhen dhe si rezultat i saj projektet e planifikuara nga burimet vetjake të shtyhen apo të mos realizohen fare.

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të siguroj që kushtet e kontratës të arritura me shfrytëzuesit e pronave publike të zbatohen në mënyrë strikte dhe që shfrytëzuesit e pronave komunale të kryejnë obligimet financiare me kohë. Në të kundërtën, kontratat duhet të rishikohen apo të shfuqizohen.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Komuna e Vushtrrisë për vitin 2014 për kategorinë Investime Kapitale dhe Mallra dhe Shërbime kishte shpenzuar 5,363,102€. Prej tyre kemi testuar 37 pagesa në vlerë prej 861,356€ apo 16% e shpenzimeve për mallra dhe investime kapitale dhe 18 mostra për aktivitetet e prokurimit në vlerë 1,533,737€.

Testimet tona kanë vënë në pah mangësitë në vijim:

Çështja 4 - Dobësitë sistematike në prokurim - prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna kishte lidhur kontratë në vlerë 22,957€ me OE të pa përgjegjshëm për “Ndërtimin me kubëza betoni të dy rrugëve lokale”. Operatori fitues nuk kishte ofruar dëshmitë e kërkuara si; kontratat për pesë punëtorë, një inxhinier të ndërtimtarisë me kontratë pune, si dhe nuk ka ofruar dëshmi për pajisjet e punës siç janë kërkuar me dosje të tenderit.
- Rreziku** Mos respektimi i kriterëve të kërkuara gjatë vlerësimit të ofertave ka rezultuar me shpërblim të kontratave ndaj Operatorëve Ekonomik të pa përgjegjshëm. Fakti që OE nuk i kishin përmbushur kriteret e kërkuara në dosje të tenderëve rritë rrezikun e pa përgjegjshmërisë në procesin e ekzekutimit të kontratës. Kjo gjithashtu, dëmton konkurrencën dhe arritjen e vlerës për para
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të inicoj një analizë për arsyet pse rastet e tilla kanë ndodhur dhe të siguroj që zhvillimi i procedurave të prokurimit bëhet konform kërkesave të LPP në mënyrë që të shpërblehen me kontratë vetëm OE të përgjegjshëm.

Çështja 5 - Dobësitë jo sistematike në prokurim- Prioritet i lartë

E gjetura

Në tenderin “Asfaltimin e tri rrugëve lokale te Komuna e Re, Fshatin Stanovc dhe Fshatin Samadrexhë” në vlerë 94,193€, procedurat e prokurimit ishin zhvilluar pa hartuar projektin ekzekutiv ashtu siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2014 të lëshuar nga KRPP. Përveç kësaj, ne kemi identifikuar se gjatë ekzekutimit të kontratës ishin bërë ndryshime substanciale të pozicioneve të kontratës pa aprovim nga Kuvendi Komunal dhe Kryetari i Komunës, por vetëm me pëlqimin e organit mbikëqyrës dhe menaxherit të projektit. Ndryshimet esenciale që ne kemi vërejtur ishin te asfaltimi i rrugës te Komuna e Re me një gjatësi prej 150 metrash, ku me kontratë parashihej që trashësia e asfaltit të jetë 19 cm, ndërsa ishte shtruar 12 cm. Diferenca e sasisë së asfaltit ishte përdorë për shtruarjen e dy rrugicave tjera në gjatësi 163 metra dhe me një trashësi asfalti prej 7cm në Stanovc, të cilat nuk ishin të parapara me këtë kontratë. Për këto rrugë të reja nuk kishte ndonjë paramasë dhe parallogari. Për shkak të këtyre ndryshimeve në punimet e kryera, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë siguri nëse punët e përfunduara ishin ekuivalente me paranë e shpenzuar.

Me kontratë gjithashtu është paraparë që për secilën rrugë të bëhet punimi dhe shqyrtimi i atesteve të ngjeshmërisë së tamponit, cilësisë së asfalt betonit dhe të trashësisë së asfaltit. Këto ateste nuk ishin bërë.

Rreziku

Ndryshimet substanciale të pozicioneve të kontratës, pavarësisht pëlqimit të operatorit, nuk lejohen me rregulloret e prokurimit. Për më tepër, ekziston mundësia që cilësia e rrugës të jetë dëmtuar, e cila fillimisht me dosje të tenderit ishte paraparë të jetë me shtresë dukshëm më të trashë. Shtruarja e rrugëve të tjera konsiderohet se është bërë jashtë të gjitha procedurave administrative. Së këndejmi, përveç papajtueshmërisë ligjore, nuk është e qartë nëse është arritur vlera për para. Rastet e tilla mund t'i shkaktojnë komunës humbje financiare.

Rekomandimi 5

Kryetari duhet të inicioj shqyrtimin e rastit pse Menaxheri i Projektit dhe Organi mbikëqyrës nuk kanë zbatuar punimet sipas kontratës fillestare si dhe të siguroj se paramasat, parallogaritë dhe analizat tjera teknike për projektet që do të tenderohen, janë kryer në mënyrë të hollësishme, dhe devijimet nga kontratat fillestare të jenë minimale. Pas shqyrtimit të rastit, ndaj personave përgjegjës të inicioj masa adekuate të përgjegjësisë. Gjithashtu, kryetari duhet të siguroj se në të ardhmen nuk do të përsëriten praktikatat e ngjashme.

4.3.2 Shpenzimet tjera

Çështja 6 - Paguesa përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit - prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2014 kishte nënshkruar memorandume të bashkëpunimit.

Komuna me 25.09.2014 kishte lidhur aneks - Memorandum me Iniciativen për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK) për realizimin e “Projektit për kultivimin e mjedrës në fshatrat e komunës së Vushtrrisë”. Anex-Memorandumi parasheh që komuna të paguaj 20,000€ në llogari të IADK-së dhe IADK 11,000€ ndërsa fermerët 4,800€. Komuna më 30.10.2014 kishte paguar 20,000€ në llogari të IADK-së.

IADK është përgjegjëse për realizimin e procesit të prokurimit dhe hartimin e planit operacional në konsultim me Komunën. Marrëveshja nuk ishte në pajtim me nenin 4 pika 2 të LPP, sepse nëse projekti financohet apo subvencionohet 50% ose më shumë nga komuna, komuna do të konsiderohet autoritet kontraktues dhe procedurat e prokurimit duhet të bëhen në pajtim me ligjin e prokurimit publik. Për këtë projekt komuna ka participuar me 56% dhe procedurat e prokurimit janë udhëheqë nga donatori;

Komuna me 12.05.2014 kishte lidhur marrëveshje me The Regional Environmental Center (REC) për rregullimin e shtratit të Lumit Sitnica. Në marrëveshje parashihet që komuna të participoj me 33% apo 20,000€ për realizim të projektit. Komuna me datën 07.07.2014 kishte paguar në llogari të REC shumën prej 20,000€. Kjo shumë nuk ishte investuar në vitin 2014, derisa në PVF është regjistruar si investim kapital;

Kryetari me datën 09.07.2014 ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) për “Rregullimin e oborrit të shkollës fillore Nazmi Zhegrova” në Stanovc të poshtëm. Në bazë të kësaj marrëveshje komuna do të participojë me 11,433€. Komuna në muajin gusht nga kategoria investime kapitale ka paguar shumën e cekur në marrëveshje; dhe

Më 25.02.2014, Nënkryetari i Komunës kishte lidhur marrëveshje me IOM-in për zvogëlimin e varfërisë dhe përmirësimin e jetës dhe rritjen e mundësive të punësimit. Me këtë marrëveshje parashihet rregullimi i rrethojave të varrezave për komunitetet Rom, Ashkalinj dhe Egjiptian (RAE) në vlerë 18,682€. IOM duhet të particoj me 10,082€ ndërsa komuna me 8,600€. Komuna në muajin mars nga kategoria investime kapitale ka paguar shumën e cekur në marrëveshje. Po ashtu, komuna nuk ka ndonjë dëshmi nëse mjetet e planifikuara nga donatori ishin shpenzuar për këtë projekt.

- Rreziku** Arsyeshmëria për pagesat në avans nuk është e qartë. Pagesat e kryera nga ana e komunës, të pa konfirmuara nëse punët/shërbimet janë përfunduar shoqërohen me rrezikun potencial që objektivat e marrëveshjeve të arrihen pjesërisht apo edhe të mos arrihen fare. Komuna duhet të ushtroj mbikëqyrje aktive në realizimin e projekteve për të zvogëluar rrezikun nga mangësitë në projekte.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të sigurojë se arsyeshmëria e pagesave në avans për bashkë financime të analizohet detajisht. Më tutje, Marrëveshja duhet të përmbajë kërkesën për raportimin e rezultateve gjatë implementimit të cilat sigurojnë një bazë solide për monitorim. Raportet finale duhet të sigurohen dhe të bëhen publike për të siguruar transparencë.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti për kategorinë e paga dhe mëditje ishte 8,597,927€ ndërsa shpenzimi për vitin 2014 ishte 8,497,773€, apo 99%.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam disa mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me kontratat e punës.

Rekomandimi

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim për këtë fushë.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna për vitin 2014 kishte planifikuar buxhetin 269,905€ ndërsa kishte shpenzuar 242,980€ apo 90%.

Ne kemi rishikuar procesin e dhënies së subvencioneve. Ne testuam mostra në shumë 42,900€ dhe nuk kemi ndonjë çështje për t'i raportuar.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur se komuna ka vazhduar procesin e regjistrimit të pasurive në SIMFK dhe kishte një progres krahasuar me vitin e kaluar. Në PVF e vitit 2014 komuna ka prezantuar pasuri neto në vlerë 46,157,808€ që krahasuar me vitin 2013 kishte 43,549,366€. Pra, kemi një rritje neto prej 2,608,442€.

Komuna kishte formuar komisionet për inventarizim të pasurive në fund të vitit, të cilët kanë përfunduar punën duke nxjerr raporte për inventarizim të pasurve.

Në fazën e ndërmjetme të auditimit kemi dhënë këshillën që të gjitha automjetet e komunës duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël dhe në fazën finale komuna e ka zbatuar këtë rekomandim. Megjithatë ne identifikuam mangësitë si në vijim:

Çështja 7 - Mos regjistrimi i duhur i pasurive komunale - prioritet i lartë

E gjetura Komuna gjatë vitit 2014 kishte regjistruar projektet kapitale jo sipas planit kontabël, pasi që disa projekte ende të pa përfunduara i ka regjistruar si projekte finale, dhe jo si investime në vijim.

Drejtorati i Shëndetësisë dhe drejtorati i arsimit ende nuk ka arritur të regjistroj pasuritë më të vogla se 1,000€ në programin e E-pasurisë.

Rreziku Mos regjistrimi i saktë i pasurive komunale, rritë rrezikun e nënvlerësimit të pasurive të komunës dhe paraqitjes jo të drejt të vlerës së tyre në PVF. Po ashtu, mos regjistrimi i pasurive në programin E-pasuria, rritë rrezikun e humbjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të pa autorizuar të tyre.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të siguroj se të gjitha procedurat e regjistrimit të pasurive do të zbatohen sipas planit kontabël dhe në pajtim me kërkesat tjera të rregullores për menaxhimin e pasurive qeveritare.

4.4.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Llogaritë e arkëtueshme në Komunën e Vushtrrisë në fund të vitit 2014 ishin 2,798,600€. Këto të arkëtueshme rezultojnë nga: tatimi në pronë, taksat në firmë, dhënia e pronës komunale me qira etj.

Çështja - 8 Trajtimi i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Llogaritë e arkëtueshme në PVF të vitit 2014 ishin 2,798,600€ dhe krahasuar me vitin paraprak ato ishin rritur për 294,390€ apo rreth 12%. Ne vlerësojmë se ka hapësira përmirësimi dhe shkalla e inkasimit mund të rritet.
- Rreziku** Mos arkëtimi i llogarive të arkëtueshme mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të shpenzimeve. Politikat jo mjaft efikase të komunës në trajtimin e llogarive të arkëtueshme kanë rezultuar në rritjen e tyre nga viti në vit dhe kjo rrit rrezikun e mos realizimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetjake.
- Rekomandimi 8** Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë e arkëtueshme do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, mundësive reale për inkasim dhe duhet të siguroj vendosjen e një plani strategjik për zvogëlimin e llogarive të arkëtueshme.

4.4.3 Trajtimi i borxheve

Çështja 9- Mos prezantim i saktë i obligimeve të pa paguara- prioritet i mesëm

- E gjetura** Komuna duket se ka kontrole të mira në menaxhimin e detyrimeve. Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2014 ishte 65,263€ ku nga kjo shumë, obligime financiare ishin 44,187€ me fatura të pranuar, ndërsa 21,076€ ishin obligime kontraktuale për paga dhe mëditje të arsimitarëve. Obligimet e tilla për paga nuk ishin raportuar në baza mujore derisa ato në PVF janë prezantuar si obligime të papaguara. Më tutje, komuna ka një zyrtar që pranon faturat, mirëpo nuk mban një evidencë të plotë të faturave të papaguara dhe faturat e pranuar nuk protokolohehen.
- Rreziku** Mos mbajtja e të gjitha obligimeve komunale në një regjistër të caktuar krijon mundësinë që obligimet të mos identifikohen dhe si të tilla rrisin rrezikun e raportimit jo të drejtë të tyre. Përveç kësaj, komuna rrezikon që të njëjtat paguaj fatura t'i paguaj dy herë.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj që të gjitha faturat të pranohen dhe si të tilla të protokolohehen dhe të evidentohen në librin e faturave, si dhe bën likuidimin e tyre me kohë.
-

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga dy auditor. NJAB-i kishte planifikuar pesë (5) raporte të auditimit, dhe në tërësi kishte përmbushë planin. Auditimet janë kryer në këto drejtori: (1) Drejtoria e Prokurimit, ku objektiv ishin procedurat e prokurimit; (2) Drejtoria e shëndetësisë - Depozitimi në bankë i mjeteve nga bashkë pagesat; (3) Drejtoria e Shërbimeve Publike; (4) Drejtoria për Buxhet dhe financa; dhe (5) Drejtoria e prokurimit.

Ne rishikuar cilësinë e raporteve të auditimit të brendshëm. Sipas mendimit tonë raportet e auditimit të brendshëm nuk kishte mbuluar fushat me rrezik të lartë.

Komiteti i Auditimit kishte mbajtur takime të rregullta dhe kishte shqyrtuar raportet e auditimit në vitin 2014.

Çështja 10 - Auditimi i Brendshëm - Prioritet i lartë

E gjetura Auditimi ynë lidhur me veprimtarinë e NJAB ka identifikuar çështjet si në vijim:

Plani vjetor i NJAB ka nevojë që të jetë më gjithëpërfshirës duke i përfshirë auditimin e shpenzimeve nga kode të ndryshme ekonomike, përfshirë edhe të hyrat vetjake; dhe

Të gjeturat nga auditimi i brendshëm nevojitet të trajtohen më në detaje, duke nxjerrë në pah efektin e gjetjeve si dhe ka nevojë të dokumentohen edhe më mirë.

Rreziku Mungesa e fokusit në auditimin e shpenzimeve dhe të hyrave vetjake ndikon që menaxhmentit të mos ketë pasqyrim të plotë mbi ecurinë e shpenzimeve dhe realizimin e të hyrave, për të arritur deri te një vendimmarrje e qëndrueshme.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj që NJAB në planin vjetor të auditimit të përfshij auditimet e llojeve të ndryshme të shpenzimeve dhe të hyrave, me fokus të veçantë kategoritë që shoqërohen nga nivele të larta të rrezikut.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Pagesat nga palët e treta	Kryetari i Komunës duhet të analizojë arsyet për dështimin në paraqitjen e drejtë të Pagesave nga Palët e treta në PVF-të fillestare dhe të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të tyre në vitin 2014.			Pa adresuar
2. Pasuritë	Kryetari i Komunës duhet të identifikojë arsyet si për keq deklarim të vlerës së pasurive, ashtu edhe dështimit në adresimin e këshillës së ZAP. Procese adekuate duhet të vihen në funksion në vitin 2014 për të siguruar se do të paraqitet saktë gjendja e pasurive kapitale dhe jokapitale të komunës.	Adresuar		
3. Përgatitja e PVF	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani për hartimin e PVF të vitit 2014 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me cilësinë e informatave dhe kërkesat specifike të raportimit.	Adresuar		
4. Rekomandimet e vitit paraprakë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë një afat kohor konkret dhe sfidues në adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.	Adresuar		

5. Qeverisja e mirë	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato.		Pjesërisht.	
6. Ekzekutimi i Buxhetit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se procesit të përgatitjes së buxhetit i paraprinë një analizë e cila pasqyron në mënyrë të plotë të gjitha informatat relevante, përfshirë shpenzimet e viteve të kaluara dhe ndryshimet e pritura nëpër vite.		Pjesërisht.	
7. Softveri i te hyrave	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë funksionalizimin e softuerit për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave.	Adresuar		
8. Keq klasifikimi i shpenzimeve	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë vendosjen e sistemit të kontrollit në këtë fushë, që pagesat të bëhen sipas kodeve adekuate.			I pa adresuar
9. Mungesa e menaxherit të kontratës	Kryetari i komunës duhet të sigurojë se pas nënshkrimit të kontratës të caktohet menaxheri i kontratës i cili do ta mbikëqyrë realizimin e kontratës që nga fillimi deri në zbatimin final të saj.	Adresuar		
10. Borxhet për punëtorët e arsimit	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se kërkesat e stafit vlerësohen me saktësi në bazë vjetore dhe të pasqyrohen në parashtrimet buxhetore. Kontratat duhet të jepen vetëm atëherë kur të sigurohet mundësia e pagesës së pagave.			I pa adresuar
11. Pagesat për mësimdhënës jo formal	Kryetari i Komunës të sigurojë mbajtjen e evidencave të mjaftueshme për numrin e orëve të realizuara për secilin mësimdhënës për të parandaluar ndikimet e mëtejme negative në buxhetin e komunës.	Adresuar		

12. E-pasuria	Kryetari i Komunës duhet të siguroj se janë ndërmarr masa që të hartoj një regjistër gjithëpërfshirës, të plotë dhe të saktë të pasurisë, të aplikojë procedura dhe kontrole të duhura në identifikimin e të gjitha pasurive si dhe të njëjtat t'i regjistroj sipas rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare të OB.			Pa adresuar
13. Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).		Pjesërisht	
14.NJAB-i	Kryetari duhet siguroj se është hartuar një plan veprimi ku përcakton se si do të reagoj në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga NJAB. Komiteti i Auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat dhe temat specifike të auditimit që do t'i trajtoj gjatë vitit.		Pjesërisht	